



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1718 prot.

Tiranë, më 20.12.2019

VENDIM
Nr. 193, datë 20.12.2019

“PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 164, DATË 10.12.2019, TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018*”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin e Agjencisë Kombëtare Bërthamore, institucion varësie i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion, i cili është raportuar nëpërmjet shkresës nr. 7205/2 prot., datë 13.09.2019, për institucionet e varësisë, duke evidentuar punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Për institucionin Agjencia Kombëtare Bërthamore është raportuar se, megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë, vazhdojnë ende të jenë në marrëdhënie me shërbimin civil nëpunësit:

- ******, me detyrë “*Specialist*”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 30.04.2018;
- ******, me detyrë “*Shef Sektori*” në Sektorin e Analizës, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 26.10.2019.

Në vijim, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri me Vendimin Paralajmërues nr. 164, datë 10.12.2019, ka vendosur:

- “1. *Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kombëtare Bërthamore, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, si dhe pasqyrimin e akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësit ***** “Specialist” dhe ***** “Shef Sektori” në Sektorin e Analizës.*
2. *Pozicionet respektive të punës, të raportohen pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicione të lira dhe DAP të vijojë procesin për plotësimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.*
3. *Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim.*
...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 164, datë 10.12.2019, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Agjencia Kombëtare Bërthamore për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, të Komisionerit, institucioni i Agjencisë Kombëtare Bërthamore përmes shkresës së dërguar me nr. 80/3 prot., datë 19.12.2019, me objekt: “*Përgjigje shkresës nr. 1718 prot., datë 10.12.2019*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1718/4 prot., datë 19.12.2019, ka kërkuar pranë këtij të fundit, shtyrjen e afatit të datës së daljes në pension për punonjësit e përmendur në vendimin paralajmërues, për shkak të specifikave të pozicionet të tyre të punës.

Konkretisht, Specialistët e Sektorit të Analizës, në Agjencinë Kombëtare Bërthamore, përpos formimit të tyre dhe përvojës së gjatë profesionale, të trajnuar në vazhdimësi në Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, janë edhe pjesëmarrës në projekte të përbashkëta me këtë Agjenci, si më poshtë vijon:

- Punonjësi ******, me detyrë “*Shef i Sektorit të Analizës*”, është i përfshirë në disa projekte të përbashkëta me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, të cilat do të vazhdojnë deri në mars të vitit 2021.

Njëkohësisht, punonjësi ***** është person kontakti dhe raportues me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, për shtetin Shqiptar, në kuadër të Konventës për Sigurinë Bërthamore, si edhe zyrtar ndërligjës për Shqipërinë me këtë Agjenci.

Gjithashtu, ky punonjës është anëtar i grupeve ndërinstitucionale në kuadrin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian për vitet 2020-2022, për Kapitujt 15 Energjia, dhe 31 Politika e Jashtme e Sigurisë dhe e Mbrojtjes.

– Punonjësi ***** me detyrë “*Specialist*”, duke qenë specialist për fosile, është i nevojshëm që të vazhdojë punën në kuadër të studimit të përbashkët me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për optimizimin e paketës së burimeve energjitike dhe energjisë elektrike në veçanti.

Gjithashtu, ky punonjës është anëtar i Komisionit të Ristrukturimit të Inspektorateve në fushën e Hidrokarbureve, si rrjedhim, jep një kontribut të rëndësishëm në realizimin e projekteve të përbashkëta me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për Energjitikën e vendit.

Në analizë të sa më lart përmendur vërej se:

Në kushtet kur, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për punonjësit ***** dhe *****, do të sillte për institucionin Agjencia Kombëtare Bërthamore pengesa në realizimin e projekteve ndërkombëtare, si dhe do të krijonte pengesa në ecurinë normale të punës së këtij institucioni, vlerësoj se, kërkesa për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 164, datë 10.12.2019, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Agjencia Kombëtare Bërthamore për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, të Komisionerit, nga ana e institucionit Agjencia Kombëtare Bërthamore është e ligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, kreu IV “*Rishikimi*”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 164, datë 10.12.2019, me përmbajtje si më poshtë:

Të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësit:

- *****, me detyrë “*Specialist*”;
- *****, me detyrë “*Shef Sektori*”, në Sektorin e Analizës,

deri në përfundimin e projekteve të cituara në përmbajtje të këtij vendimi, nga ana e punonjësve.

2. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia Kombëtare Bërthamore, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamenti i Administratës Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha